



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT**

Nr. 6253 / prot.  
1

Tiranë, më 20.9.2018

**Drejtuar:**

**Z. Gramoz RUÇI**

**KRYETAR I KUVENDIT TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

**z. Ulsi MANJA**

**KRYETAR I KOMISIONIT TË LIGJEVE TË KUVENDIT TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

Të nderuar,

Në vijim të kërkesave të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit me 1) shkresën nr. 4938 prot., datë 26.06.2018, "Kërkesë për shtesë personeli në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit", si dhe 2) shkresën nr. 4684 prot., datë 12.06.2018 "Kërkesë për përfshirjen e Komisionit të Pavarur të Kualifikimit në VKM nr. 187, datë 08.03.2017, po ju dërgojmë bashkëlidhur propozimet për ndryshime në vendimin e sipërcituar të Komisionit, të cilat konsistojnë në:

- Ndryshimin e tekstit të vendimit me qëllim pasqyrimin e plotë të përfitimeve për të gjitha pozicionet e punës së personelit në këtë institucion, sipas VKM nr.187/2017, të cilat i përfitojnë të gjithë punonjësit e institucioneve buxhetore, por për arsye të mospasqyrimin të saktë të vendimit, personeli i Komisionit nuk i përfiton ende, si dhe shtesën në masën 20.000 lekë për nëpunësit në pozicionet në njësitë organizative IV dhe V, si dhe shtesën prej 10.000 lekë për nëpunësit në pozicionet në njësinë organizative VI.
- Shtimin e numrit të punonjësve me 8 këshilltarë ekonomikë, 2 specialistë të sekretarisë gjyqësore, 2 përkthyes, dy specialistë të Protokoll-Arkivës, një punonjëse pastrimi, si dhe një specialist për prokurimet. Po ashtu ndryshimin e kategorisë për pozicionin "shofer" në "shofer korrier", nisur edhe nga detyrat që ai kryen aktualisht.

Argumentat e këtyre ndryshimeve janë të pasqyruara në shkresat tona nr. 4938 prot., datë 26.06.2018, dhe shkresën nr. 4684 prot., datë 12.06.2018. Ato janë në vijim të fluksit të madh të punës së Komisionit, por edhe nisur nga fakti se, në kohën e miratimit të vendimit të Kuvendit nr.93/2017, ende nuk kishim një pasqyrim të qartë mbi volumin e punës dhe intensitetin e saj.

Duke shpresuar në mirëkuptimin tuaj,

Me konsideratë,

**KRYETARI**  
**GENTA Tafa (BUNGO)**

